

## KONKLUZIONET E DAKORDUARA – 2 DHJETOR 2011

### Konkluzionet e dakorduara të IBM<sup>1</sup>-it

1. Në përputhje me Traktatin e Lisbonës dhe legjislacionin relevant të BE-së<sup>2</sup> dhe duke pasur parasysh se të dy palët janë pjesë e agjendës së BE-së për Ballkanin Perëndimor, atyre do t'ju kërkohet që gradualisht të harmonizojnë legjislacionin e tyre më atë të BE-së dhe në veçanti ta zbatojnë konceptin e IBM-it;
2. Në interes të procesimit më të shpejtë dhe më efektiv, palët, nën drejtimin e përgjithshëm të BE-së, do ta zbatojnë konceptin e IBM-it;
3. Palët kanë për qëllim që të instalojnë gradualisht objekte të përbashkëta dhe të sigurta në të gjitha vendkalimet e tyre të përbashkëta të IBM-it. Ky bashkëpunim do t'i ndjek praktikën më të mira evropiane të cilat janë duke u zhvilluar më tutje në mënyrë progresive nga Komisioni Evropian. Kësaj pune do t'i jepet prioritet i lartë; projektet do të identifikohet bashkërisht dhe do të zbatohen sa më parë që praktikisht të jetë e mundur.
4. Objektet e përbashkëta, të integruara, të vetme dhe të sigurta do të vendosen përbrenda një "zone të përbashkët të vendkalimeve të IBM-it," të shënuar bashkërisht, ku zyrtarët e secilës palë kryejnë kontrollet përkatëse. Përgjatë kufirit dhe kufizuar vetëm në zonat e përbashkëta të vendkalimeve të IBM-it, palët nuk do të shfaqin simbolet e juridiksioneve të tyre përkatëse.
5. Aranzhimet do të përfshijnë një prani të balancuar, në përputhje me nevojat, nga të dy palët të shërbimeve përkatëse siç janë Doganat, Policia, etj. dhe do të përfshijnë çështje siç janë lokacioni, vendkalimet, natyra e objekteve përcjellëse, orari i punës etj. Në përputhje dhe gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij<sup>3</sup>, në vendkalimet Jarinjë/Rudnicë dhe Tabavije/Bërnjak, kjo prezencë do të përfshijë zyrtarë të EULEX-it. EULEX-i do të jetë i pranishëm poashtu në vendkalimet Dheu i Bardhë/Konçul, Merdare/Merdarë, Mutivodë/Mutivode dhe Depce/Muçibabë;
6. Në thelb të marrëveshjes do të jenë përgjegjësitë dhe detyrimet e qarta ligjore në fuqi sipas juridiksionit të secilës palë.
7. Një grup trepalësh implementues, kryesuar nga BE, do të formohet për zbatimin e marrëveshjeve të lartpërmendura, sa më parë që praktikisht është e mundur. Për këtë qëllim një Protokoll Teknik do të hartohet dhe nënshkruhet, nëse është e nevojshme ndarazi me BE-në, i cili do t'i marrë parasysh pikëpamjet e ndryshme të palëve lidhur me çështjen e statusit. Implikimet e këtyre konkluzioneve do të merren parasysh në zbatimin e lirisë së lëvizjes.
8. Kjo marrëveshje nuk përfshinë asnjë çështje të përgjithshme ose të veçantë që ka të bëjë me çështjet e të hyrave apo ato fiskale;

<sup>1</sup> Njëra palë e njeherë vijën si kufi; pala tjetër e njeherë vijën si kufi administrativ.

<sup>2</sup> Siç është përcaktuar veçanërisht me Kodin e Shengenit për Kufijtë, Rregulloren e Frontex-it, Rregulloren e Trafikut të Kufijve Lokal, Rregulloren VIS dhe Kodin e BE-së për Vizat;

<sup>3</sup> Siç është përcaktuar me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124 CEFSP, kreu 3, pjesa a.